




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e dhjetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.11.2022, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv.Kryesuesi i Kuvendit zt.Ramush Mehmeti, Nënkryetari i Komunës për Komunitete zt. Bajrush Ymeri, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhiu, Dobrivoje Djordjevic, Abdyl Gashi, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Ivica Cenic, Violeta Milosevic Drejtori i Financave zt.Milos Denic, Drejtori i Administratës zt.Serboljub Djokic, Drejtori i Urbanizmit zt.Bojan Peric, Drejtori i Zhvillimit Ekonomik zt Nexhat Mehmeti, Drejtori i SH.P.M.SH. përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit e cila pasi pershendeti të gjithë të pranishmi tha: konstatoj korumin prezent janë 14 anëtarë nga 15 anëtarë gjithësej të Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Shoqatës së Zjarrëfiksive vullnetarë të Gjilanit;
3. Shqyrtimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Komunës së Graqanicës;
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit për Formimin e KKSB-së;
5. Raport Komunal mbi vlerësimin e objekteve banesore, në Komunën e Novobërdës;
6. Raport i pergjithshëm për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/23 nga Drejtoria e Arsimit;
7. Të ndryshme;

Kryesuesja i pyeti se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: e kam një pikë për rend dite, kjo pikë i perket Drejtorisë së Urbanizmit por pasi që nuk është Drejtori prezent po e prezantoj unë e në ndërkohë besoj se do të vij, bëhet fjalë për një memorandum mirëkuptimi në mes të Komunës së Novobërdës dhe Greenium shpk ku kanë për qëllim ndërtimin e parkut diellor Artana 1 dhe Artana 2 për zhvillimin e aktiviteteve të prodhimit të energjisë diellore dhe zhvillimin e një jete më cilësore për banorët e fshatit.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: propozoi që pika e 4 të tërhiqet nga rendi i ditës, pasi që propozim vendim nuk është me emrat dhe kërkoj që propozim vendimi të vij me emra konkret.

Kryesuesja tha: votojm për të dy propozimet veç e veç. Kush është për propozimin e Drejtorit të Financave?. Me 11 vota për, 2 apstenime aprovohet propozimi për piken shtesë në rend dite.

Procesverbali i Kuvendit

Pastaj Kryesuesja kërkoj të votojnë për ta terhequr piken e 4. Me 8 vota për, 2 kunder (Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu) dhe 3 apstenime terhiqet pika e 4 nga rendi i ditës.

Pasi nuk pati propozime dhe diskutime tjera me 13 vota për aproovhet rendi i ditës me propozimin e Drejtorit të Financave dhe zv.kryesuesit të Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Zv.kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime aprovohet njëzëri procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë: Shqyrtimi i memorandumit të mirëkuptimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Shoqatës së Zjarrëfiksive vullnetarë të Gjilanit;

Për këtë pikë ja dha fjalen D.SH.P.M.SH Gafurr Vllasaliu.

Gafurr Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: qëllimi këtij memorandumi është mbrojtja e njerëzve nga zjarret, fatëkqësit natyrore dhe fatëkqësit e tjera. Stacioni i Novobërdës operon me 9 zjarrëfikës, disa me gjendje jo të mirë shendetësore, prandaj me teritor 204km² është krijuar nevoja për këtë memorandum mirëkuptimi me Shoqaten e Vullnetarëve të Gjilanit.

Kryesuesja tha: na tregoni se cilat janë ato ndryshime në memorandum na jepni disa informata më shumë.

Gafurr Vllasaliu tha: pasi që në inicimin që kemi bërë në mbledhjen e kaluar kanë qenë 22 anëtarë ndërsa tani janë 32 anëtarë në bazë të territorit dhe në bazë të kërkesave që i kemi.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime me 14 vota për nga të gjithë antarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Miratohet propozimi i kryetarit të Komunes së Novobërdës për të hyrë në bashkëpunim me shoqaten e vullnetarve të zjarrfikësve të Komunes së Gjilanit (SHVZ).

Pika e tretë: Shqyrtimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes të Komunës së Novobërdës dhe Komunës së Graqanicës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalen Milos Denic.

Milos Denic tha: pasi që Drejtori i Inspeksionit nuk është prezent unë do ta prezantoj këtë pikë, qëllimi është që punëtorët e Drejtorisë së Inspeksionit të marrin këshilla. Me buxhetin e vitit 2022 janë 3 punëtorë ndërsa me buxhetin e vitit 2023 janë planifikaur që ti kemi 10 punëtorë, kaq nga unë për fillim nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: unë së pari ndjej shqetësim pasi që nuk është prezent as Drejtori i Inspeksionit këtu që ta bëjë një prezantim. Kjo i bjen që është paaftësi lokale e qeverisjes, pasi që ka pasur mjaft kohë deri tani që të bëjë një zgjidhje më të mirë ku do të jen të përfshirë edhe inspeksioni prej Komunës sonë. Njëherë bënen tentativa që me shu komplet Drejtorin e Inspeksionit, ndërsa tani po kërkojnë që të marrin inspektor nga Komuna e Graqanicës. Nuk po e kuptoj pse të anashkalohej Kamenica, Gjilani dhe Lipjani e të shkohet direkt në Graqanic për me e bë një inspeksion e me i inspektu banorët dhe bizneset e Komunës së Novobërdës. Unë mendoj se një iniciativ e tillë nuk ish dashtë të votohet, e as të përkrahet të pakten këtë padrejtësi duhet ta kundërshtoj Nënkryetari i komunitetit shqiptarë, poashu edhe zv.kryesuesi i cili eshte i thirrur për ti mbrojtur interesat e komunitetit shqiptarë pa dallim edhe të komuniteteve tjera.

Kryesuesja tha: nuk e di sa arrihet me e lexu memorandumin por është në interes të Komunës sonë ky memorandum.

Ramush Mehmeti tha: po nderlidhem me diskutimin e Abdylit, unë e di se Kryetari ka tentuar që të lidhë memorandum edhe me Komunën e Gjilanit mirëpo pasi që nuk ka pasur mundësi pasi që Komuna e Gjilanit ka vetem ingjiner të ndertimtarisë për këtë arsye janë drejtuar në Komunën e Graqanicës.

Stojan Stajonevic pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe më herët kur ka qenë kjo iniciativ, kam thënë se është një levizje e mirë, ne duhet të kemi njerëz të mirë, a janë nga Graqanica apo nga janë ska lidhje por vetem duhet të kryhet puna që ju takon, dhe kerkoj nga të gjithë ju që ta përkrahni, nuk e di a është emruar ende Drejtori i Inspeksionit por kerkoj që kjo punë të kryhet.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për, 1 kunder (Abdyl Gashi) aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Miratohet nisma e Kryetarit të Komunes së Novobërdës për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal.

Pika e katërt: Raport Komunal mbi vlerësimin e objekteve banesore, në Komunën e Novobërdës;

Për këtë pikë Kryesuesja ja dha fjalën Milos Denic.

Milos Denic tha: kjo pikë duhet të jetë vlerësimi i objekteve banesore të palevizëshme. Besoj se materialet i keni marrë me kohë dhe e keni para vetes. Këto objekte të cilat janë, vlerësimin e ka bërë Ministria e Financave, ata e kanë pregaditur këtë raport për pronat rezidenciale në bazë të kategorive të cilat janë dhe ndryshimet të cilat janë propozuar janë nga Ministria e Financave, ata na kanë thënë se nuk duhet të bihet ndonjë vendim në Kuvend por vetem duhet të informohen antarët e Kuvendit. Ata i kanë vlerësuar zonat e të gjithë teritorit të Komunës dhe e kanë përcaktuar vlerësimin. Hapsira e tokës që ka qenë më herët si zonë e dytë është rritur vlere dhe do të rritet vlere tatimore, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmit tha: isha pajtu me këtë që tha Drejtori, por një numer i madhë i ndertimeve as nuk janë regjistruar dhe legalizuar dhe nuk paguajn tatim, ndërsa njerëzit që kanë paguar tatim me ju rrit tatimi nuk është në rregull.

Pika e pestë: Raport Komunal mbi vlerësimin e objekteve banesore, në Komunën e Novobërdës;

Kryesuesja tha: e kemi marrë këtë propozim për rend dite në mbledhje të KPF-së nga kolegu Abdyl Gashi por siç duket askush nuk është prezent që ta prezantoj këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: kjo pikë ka qenë edhe kërkesë e komitetit për komunitete në mbledhjen e kaluar e kam udhëhequr ka qenë kërkesë edhe e antarëve të Kuvendit, e njejta kërkesë po përseritet që disa herë dhe ende nuk ka asnjë raport. Unë e mora fjalën pasi që pata marrë për obligim me bisedu me Kryetarin por fatkeqësisht nuk kam pasur mundësi që të takohem, kjo është shqetësuese pasi që tri herë Kuvendi ka kërkuar dhe asnjëherë nuk është raportuar.

Stojan Stanojevic tha: mos me keqkuptoni pasi që nuk kam kunder askujt por të gjithë Drejtorët kanë ardhë kohë pas kohe në mbledhje të Kuvendit, vetem D.A nuk ka ardhë asnjëherë. Gjithashtu kam vërejtje për materialin që nuk po e marrim kopje fizike andaj ju kus Kryesuese që për mbledhjen e ardhshme të na dergoni materialin edhe në kopje fizike.

Kryesuesja tha: shtatë ditë para ne ju dergojmë materialin ne email, materialin që e marrim para mbledhjes as ne nuk mund ta dergojm me herët. Sa i perket kopjes fizike do të mundohemi që t'ju dergojm me kohë.

Stojan Stanojevic tha: materialin të na dergoni në kopje fizike më herët.

Kryesuesja tha: çdo anëtarë mundë të kërkoj nga Kuvendi pika për rend dite, e rëndësishme është se ne i fusim këto pika në rend dite dhe e kërkojm raportin por ne nuk mundë ti detyrojm që të vijmë të raportojmë.

Dobrivoje Djordjevic tha: nese ju kujtohet ju më së shumti e keni sulmuar Kryesuesin në mandatin e kaluar për Drejtorin e Arsimit se pse nuk po merr pjesë, pse ju tash nuk po e njoftoni Kryetarin për Drejtorin e Arsimit që nuk po vjen në mbledhje, këtë po ju dhë vetem si këshillë.

Kryesuesja tha: do të kërkoj që të raportoj por nuk mundë ti detyrojmë.

Abdyl Gashi tha: nuk është e rëndësishme se kush ka kërkuar që të vij Drejtori i Arsimit të raportoj por e rëndësishme është se ne nuk po kemi raport. Perderisa Drejtorat marrin pagë prej buxheti të kësaj Komune e kanë për obligim që të raportojmë në këtë Kuvend. Unë besoj se për mbledhjen e radhes përseri do ta fusim në rend dite deri sa të vij Drejtori që të raportoj.

Pika e gjashtë: Iniciativa e Kryetarit të Komunes së Novobërdës për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Greenium shpk.

Për këtë pikë ja dha fjalën udhëheqësit të Kadastrit zt.Selatin Beqiri.

Selatin Beqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: e kemi këtë pikë për rend dite ku duhet të nënshkruhet një memorandum bashkëpunimi, bëhet fjal për kompanin Greenium shpk për solarë dhe panele, ku kjo kompani ka ofruar marrëveshje për 10 vite për ndihmë në shëndetësi dhe arsim, ku i plotëson të gjitha kushtet sipas qytetarëve të Komunës. Invesitor është Naim Bajraktari që ka propozuar që të bëhet kjo marrëveshje.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pranvera Kastrati Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: materialin ne e murrem por jo me kohë, sa i perket solares në fshatin Llabjan kemi bërë peticion e gjithë lagjja dhe e kemi derguar te Kryetari i Komunës pasi që është një gjë e patolerueshme, është kancerogjene për qytetarët, janë shumë afër shtepive. Nese votohet kjo pikë keni me marrë përgjegjësi me u përball me gjykata ju dhe drejtorët e komunës. Unë jamë kunder kësaj pike kategorikisht pasi që është në dëm të qytetarëve.

Kryesuesja tha: në memorandum neni 2 thot se Greenium shpk ka marrë aprovimin nga Agjencia Pyjore për shfrytëzimin e tokës në pronësi të Agjencisë Pyjore, janë të cekura gjithashtu edhe numrat e parcelave, pra kolege është në bazë të ligjit.

Bojan Peric tha: e respektoj antarën e Kuvendit znj.Pranvera, por kjo kompani që ka aplikuar për këtë projekt ka marrë pajtueshmerin prej departamentit të pylltarisë, këtë pajtueshmeri e ka marrë qysh në fillim të vitit 2022. Invesitori ka propozuar ta nxis zhvillimin dhe ai ka shprehur dëshirën që të investoj.

Bajrush Ymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: po deshiroj që të jap një kontribut timin për shqetësimin të cilin e paraqiti këtu antarja e kuvendit, fillimisht e dini që kompania Greenium shpk dhe një kompani tjetër kanë paraqitur kërkesë në Komunën tonë ku është marrë një njoftim se këto parcela të cilat i kanë kërkuar nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural a janë të përfshira në planet tona zhvillimore apo jo sepse toka është pronë e Ministrisë dhe ata me njoftimin nga ana e Komunës e dhëjnë në shfrytëzim për ata që e kërkojnë. Tani pas kërkesave që i kanë bërë këto dy kompani, fillimisht ka pasur edhe disa probleme deri ka ardhë deri këtu, e pastaj i kemi organizuar dy debate publike me qytetarë dhe në ato dy debate publike këto kompani i kanë sqaruar në përpikëri se çka dojnë me vepru, njëra ka propozuar për ndertimin e mullirëve për energjin me erë, ndërsa pjesa tjetër është kundërshtu nga banorët lokal që jetojnë në atë pjesë dhe është bërë një peticion. Në ndërkohë janë dhënë sqarime shtesë dhe janë organizuar takime me qytetarë dhe kanë arritur marrëveshje mirëkuptim ku qytetarët janë pajtuar që kompania nese plotëson disa kërkesa të tyre atëherë ata janë të pajtimit mos me kundërshtu, në këtë rast qytetarët kanë shpreh shqetësim që mos të vendosen këto panele solare rreth shtepive të tyre por të vendosen në një distanc, e pastaj e kanë marrë driten e gjelbert për me ec tutje. Kryetari i Komunës i ka kushtëzuar që nese e fillojnë këtë projekt ata e kanë për obligim të ndertojnë një parkë për fëmijët e atyre qytetarëve përreth, të marrin parasysht punësimin e atyre qytetarëve kur vjen puna e punësimit po ashtu e kanë për obligim për 10 vite nga 5,000€ ti paguajn Komunës në emer të shpenzimeve për shendetesi dhe arsim. Pra ne gjendemi në një situat mjaft të vështirë sa i përket energjisë, kjo energjia e ripërtritshme edhe në Kosovë ka filluar me përmasa më të mëdha. Sa janë të dëmshme unë nuk e di pasi që nuk jamë ekspert i asaj fushe por fakti se po vendosen në kule të shtëpisë, e në garazha, tregon se nuk kanë rrezikshmeri. Me pas qenë e dëmshme për banorët dhe ambientin nuk ja kishin dhënë pëlqimin, ju falminderit.

Pranvera Kastrati Gashi tha: te nderuar antarë të Kuvendit krejt çka thanë nuk është asnjë, pasi që është kancerogjene 100%, uji 100% nuk pihet në atë vend. Ai paska thënë që do të ndihmoj në shendetësi por si do të ndihmoj kur është kancerogjene. Ju bëjë apel që asnjë mos ta votoni pasi që është jashtëmase e rrezikshme dhe kërkoj nga Kryesuesja e Kuvendit që ta tërheq këtë pikë.

Kryesuesja tha: e kanë pajtueshmerin nga Agjencia Pyjore dhe kjo është pronë e pylltarisë, ne si Kuvend vetem e aprovojm, është Ministria ajo që ju ka dhënë aprovimin.

Abdyl Gashi tha: unë kam marrë pjesë në dy debate prej dy Kompanive që u permenden më herët shqetësimet kryesore kanë qenë për qasjen në ujë të pishem dhe rrezikohen për ujë. Nuk besoj se janë të dëmshme perderisa edhe Ministria i jep licenc.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 11vota për, 1 kunder (Pranvera Kastrati Gashi) dhe 2 apstenime nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Miratohet Iniciativa e kryetarit të Komunes së Novobërdës për të nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Greenium shpk.

Pika e shtatë: të ndryshme;

Kryesusja tha: pasi që Drejtori i Kadastrit është këtu po e njofotoj se ne në Kuvend po marrim kërkesa të ndryshme dhe njëra prej tyre është qasja në rrugë dhe ndryshimin e rrugës në një parcel. Por në bazë të ligjit për çdo kërkesë duhet të kemi një shkresë zyrtare nga Drejtori i Kadastrit se a është në pajtim me ligjin apo jo. Gjithashtu sa i përket kërkesës së zt.Nexhmedin Beqiri unë duhet që ta kem një shkresë zyrtare se a është në pajtueshmeri me ligjin.

Ramush Mehmeti tha: në seancen e kaluar të Kuvendit jemi dakorduar që për këtë mbledhje ta kemi materialin në formë zyrtare dhe kjo kërkesë është bërë që 7-8 muaj dhe është neglizhenc e punës tonë nese si kthejm pergjigje.

Kryesuesja tha: për ta votuar na duhet pajtueshmeri se a është në bazë të Ligjit.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: qytetarët kanë të drejt dhe ky qytetarë ka të drejt pasi që disa seanca vjen kërkesa e njejtë, por këtu nuk është faji i antarëve të Kuvendit por i Drejtorisë së Urbanizmit, gjithashtu ne patem formuar një komision për ndryshimin e pronave dhe dhënjën në shfrytëzim dhe ne si Kuvend nuk mund ti ikim procedurave të cilat i kemi, pasi që aty bëhet fjalë për një pronë Komunale ti ndrrohet destinacioni dhe menodj se Drejtori i Urbanizmit duhet ti drejtohet komisionit.

Kryesusja tha: duhet ta kemi materilain e kompletuar, pasi që është vetem kërkesa dhe një skic.

Stojan Stanojevic tha: mendoj se kjo kërkes ka ardhur që nga muaji Mars dhe qështja e kësaj rruge mendoj se duhet të zgjidhet.

Bajrush Ymeri tha: znj.Kryesuese unë ju kisha lut të gjithëve, në këtë rast edhe duke u nis prej teje, Kryetarit, Nënkryetarit, Drejtorëve, atarëve të Kuvendit sa më pak burokraci, qytetari që 5 muaj ka që ka bërë kërkesën, ai nuk është fajtor pasi që e ka sqaruar në mënyrën më të mirë të mundshme për me ju lehtësu qasja në pronën e vet, ai po fal tokë nuk po merr, ajo rrugë aktualishtë është e mbyllur nuk po kalon askush. Qytetari po kërkon me bë zgjidhje edhe për veti edhe pronën e vet.

Kryesusja tha: nuk është kërkesa e vetme, kemi shumë kërkesa në Kuvend për qështje të ngjajshme, vetem kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit të na drejtohet me dokument zyrtare se kjo kërkesë është në bazë të ligjit.

Bojan Peric tha: nuk kërkohet ndryshim i trases rrugore por vetem zhvendosje e rrugës, gjithashtu edhe kërkesën e Remzi Syles e kemi derguar nuk e di a e keni marrë apo jo, nuk ka asgjë të paqartë në këtë kërkesë.

Kryesusja tha: ne kemi pranuar vetem kërkesën dhe një skic nuk janë dokumentat e kompletuar nese ju e dergoni shkresen se është në bazë të ligjit nuk ka asnjë problem.

Dobrivoje Djordjevic tha: me kërkesën e një numri të madh të gjuetarëve të komunës së Novobërdës, nuk jam gjuetar dhe nuk e ndjej pasionin me të cilin flasin për gjuetinë por ju premtova se do ta ngre çështjen e shoqërisë gjuetare, që në bashkëpunim me Kryetarin do të shihnim se si të zgjidhej problemi i shoqërisë së gjuetisë. Jane te zhgenjyer dhe kerkojne vetem nje zgjidhje qe te mund te dalin ne gjueti, sepse kane 2 vjet qe nuk kane dale. A ka ndonjë mundësi ligjore për të takuar njerëz e shoqatës së gjuetarëve përpara përfundimit të çështjes gjyqësore?.

Procesverbali i Kuvendit

Kryesusja tha: problemi është se lënda ka shkuar në gjykat dhe kur të vij vendimi nga gjykata atëherë në mundë të ndërmarrim ndonjë gjë, pa pasur vendim prej gjykates nuk mundë të bëjmë asgjë.

Abdyl Gashi tha: problemi është se kur po bisedojn më qytetarët po i thojnë unë ta kry këtë punë, unë ta kry këtë punë, këtij banori po i bëhet një padrejtësi shumë e madhe që një kohë e gjatë për me e zhvendos rrugën, drejtori duhet ta dij se a është në harmoni me ligjin dhe procedurat.

Kryesusja tha: nuk jam kunder qytetarëve as kunder askujt, nuk është kërkesa e veteme, ne kemi shumë kërkesa dhe vetem po presim nga drejtorja se a ka bazë ligjore.

Stojan Stanojevic tha: pse nxemja nuk po funksionon.

Kryesusja tha: nxemjet kanë filluar të punojn dhe të funksionojn por do të shohim edhe mundësin për blerejn e ndonjë klimes.

Abdyl Gashi tha: po e ngriti edhe një qështje që e kemi diskutuar dhe aprovuar që seancat me u transmetu në ëeb faqe online dhe kjo nuk po ndodh, cila është arsyeja nuk e di. Unë po ju paralajmëroj që prej seancen së radhes e kam për obligim që me ingjizu gjithë mbledhjen si asambleist.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:35.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

